



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Maliq, më 25/04/2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. 6, datë 25/04/2024

PËR

“Disa ndryshime në Vendimin nr.137, datë 27.12.2023 “Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë dhe Strukturave të tjera, për vitin 2024”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma (b), neni 54, gërma (ç), neni 55, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.137, datë 27.12.2023 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civile e punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, këshillit të Bashkisë Maliq

I PROPOZOJ:

- I. Të miratojë disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:
- 1- Në struktura e Njësive Administrative , Lidhja nr.2, Njësia Administrative Gorë të bëhet ndryshimi i pozicionit të punës si më poshtë:
 - Pozicioni i punës “**Specialist Inspektor Tatimor**”, me kategorinë IV –a , me pagë **31.000** (tridhjet e një mijë) lekë dhe shtesë për vjetërsi në masën 2% dhe të ndryshohet dhe të bëhet “**Punonjës Inspektor terreni**”, me 8 orë punë me pagë **40.000 (dyzetëmijë) lekë** dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.
 - 2- Në struktura e Sektorit i Trashëgimnise Kulturore Turizmit, Lidhja nr.3, të bëhet shtimi i pozicionit të punës si më poshtë:
 - Pozicioni i punës “**Daultar**”, me 8 orë punë në ditë në masën **40.000 (dyzet e tre mijë) lekë** dhe shtesë për vjetërsi në masën 1%.
 - 3- Në struktura e Drejtorisë së Shërbimit Publik, Lidhja nr. 5 të bëhet shtesa për pozicionin e punës si më poshtë:
 - Në Sektori i Shërbimeve Përgj, të shtohet pozicioni i punës “**Punonjës pastrimi shkolla në fshatin Kakaç**”, me 4 orë punë me pagë **20.000 (njëzetëmijë) lekë** dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.
- II. Efektet Financiare të këtij Vendimi fillojnë pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Korçë dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Maliq për vitin 2024.
- III. Për nxjerrjen e urdhrat për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- Ky vendim hyn pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

